



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 19
Prishtinë, më 07. 10. 2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-203

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviç, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati, Naim Rustemi dhe Vezira Emrush - anëtarë.

Të ftuar ishin:

Prenk Gjetaj - kryetar i Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur

Mbledhjen e monitoruan:

Përfaqësuesi i Presidencës së Kosovës dhe përfaqësuesja e OSBE-së .

- Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj

Mbledhjen e kryesoi Ismet Beqiri - kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R e n d d i t e

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 2 Takimi me kryetarin e Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur që do ta informojë Komisionin Parlamentar lidhur me Projektligjin për persona të pagjetur,
- 3 Shqyrtimi i disa peticioneve,
- 4 Të ndryshme

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari Konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

2 Takimi me kryetarin e Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur që do ta informojë Komisionin Parlamentar lidhur me Projektligjin për persona të pagjetur

Kryetari – Theksoi se qëllimi i takimit me z. Prenk Gjetaj ishte që për së afërmi ta njoftonte Komisionin për Projektligjin për persona të pagjetur dhe e ftoi ta merrte fjalën.

Prenk Gjetaj – Kryetar i Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur shtoi: Sponsorues i Projektligjit për persona të pagjetur është Ministria Drejtësisë. U bë një vlerësim kritik nga ekspertët e fushave përkatëse dhe u konstatua se Projektligji ka mangësi dhe u kthye për plotësim. Projektligji mbështetet në përvojat e Bosnjës dhe të Hercegovinës dhe së shpejti do t'i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ai e falënderoi USAID-in për mbështetjen teknike dhe financiare që është duke e ofruar.

Kryetari e falënderoi homologun për paraqitjen dhe e hapi debatin.

Prof. dr. Nerxhivane Dauti – Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit shtroi pyetje: Cilat janë grupet e punës që e hartojnë këtë projektligj? Ministria përkatëse nëse është e paaftë për draftimin e tij, t'i lejohet Komisionit Parlamentar sepse ka kapacitet me ekspertë dhe mbështetje në Rregulloren e punës së Kuvendit.

Drita Maliqi – Kërkoi më shumë njoftim për mangësitë e Projektligjit dhe kërkoi nga Komisioni Qeveritar përshpejtimin e procedurave, sepse fusha përkatëse ka mbetur e pambrojtur institucionalisht.

Sanije Alijaj – Kërkoi sqarim lidhur me rolin e Zyrës së Qeverisë për Persona të Pagjetur. Shprehu shqetësimin lidhur me kushtëzimin e këtij projektligji me Projektligjin për çështje sociale. Në këtë kontekst e shtroi nevojën e harmonizimit me ligj të statusit, të drejtave të familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së dhe të familjeve të viktimave civile të luftës. Gjithashtu i propozoi Komisionit Parlamentar t'i bashkëngjitet grupit të punës për draftimit e Projektligjit.

Naim Rrustemi – Ishte i mendimit se në këtë mbledhje duhet të marrë pjesë sponsoruesi i Projektligjit - Ministria e Drejtësisë dhe të informohet se në cilin stad ndodhet. I njoftoi të pranishmit për rregullat e Rregullores së punës të Qeverisë së Republikës së Kosovë lidhur me procedimin e projektligjeve. Nëse konstatohet se Ministria e Drejtësisë nuk ka kapacitet për hartimin e Projektligjit, atëherë Komisioni Parlamentar ta marrë nismën që të mos prolongohet ligji.

Ibrahim Makolli – Shprehu shqetësim për neglizhencën në hartimin e Projektligjit, që do të rregullonte koordinimin, identifikimin, përkrahjen e familjeve të personave të pagjetur, me statusin e personave të pagjetur dhe kërkesën për gjetjen e tyre, si dhe me ndërprerjen e statusit të tyre etj. Ishte kategorik që ligji të mos parasheh rolin e shoqatave ,nga se ato veprojnë sipas .ligjit për OJQ-të ,por vetëm të kategorisë për të cilën flitet,pra me statusin e personave të pagjetur dhe familjeve të tyre .

Luljeta Shehu - Shtroi pyetjen: Çfarë dallimi do të ketë në rregullimin e të drejtave të kësaj kategorie ndërmjet Ligjit dhe Projektligjit për persona të pagjetur të statusin dhe të të drejtave të familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së dhe të familjeve të viktimave civile të luftës

Hajredin Hyseni - U angazhua për një projektligj që do ta rregullonte çështjen e personave të pagjetur dhe që do të ishte në pajtueshmëri me ligjet e tjera.

U pajtua që nga Komisioni të marrë pjesë më 12. 10. 2008, kur ekspertët do të debatojnë lidhur me Projektligjin.

z. Gjeta- iu përgjigj pyetjeve të parashtruara dhe u mirëpritën nga ana e tyre .

Në fund u konstatua një pakënaqësi e përgjithshme lidhur me vonesën e Projektligjit për persona të pagjetur që edhe pas shumë kohësh nuk është hartuar nga sponsoruesi - Ministria e Drejtësisë.

3. Shqyrtimi i disa peticioneve

Prof. dr. Nerxhivane Dauti - I njoftoi anëtarët për përmbajtjen e peticionit të Shoqatës së ish - të Burgosurve Politikë dhe të Pengjeve të Luftës nga Gjakova, nr. 02/L-2 të datës 21. 6. 2008, që kërkojnë të kenë mbrojtje institucionale si të tjerët, sepse dënimin e kanë vuajtur në Burgun e Dubravës.

Raportuesja i rekomandoi Komisionit që peticioni t'i drejtohet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, pasi Projektligji për ish-të burgosurit politikë të Burgut të Dubravës është në përfundim.

Shkresa nr. 02-673 e datës 27. 3. 2008 e ushtruar nga Lidhja e Invalidëve të Luftës së Dytë Botërore kërkon që edhe kjo kategori të gëzojë mbrojtje institucionale.

Raportuesja propozoi që Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale t'i dërgohet shkresa , sepse është partner dhe duhet të përkujdeset deri sa të hartohet ligji i veçantë.

Kryetari e falënderoi raportuesen për punën që është duke bërë për shqyrtimin e peticioneve dhe për mendimet që ia prezanton Komisionit për procedim të mëtejshëm.

4. Te ndryshme

Komisioni debatoi për disa çështje që i përkasin fushëveprimit të tij.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

E përgatiti:

Rrahim Demaj, zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri